



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 334/6 Prot.

Tiranë, më 14.09.2023

V E N D I M

Nr. 184, Datë 14.09.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 35, datë 03.03.2023, e paraqitur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), në emër të gazetarit P.Gj¹ kundër Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë (DVP Lezhë), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, linjës kritike të televizionit Fax News dhe “*çdo shkak tjetër*”².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash, informon se: “Komiteti Shqiptar i Helsinkit në datë 20.05.2021, është njohur me ankesën e shtetasit P.Gj me profesion gazetar. Ai pretendon se në datë 11.04.2021 është shoqëruar në mënyrë të paligjshme nga punonjës të Policisë së Shtetit në Komisaratin e Policisë Lezhë. Motivacioni i këtij veprimi procedural ka qenë i lidhur me dyshimin e pjesëmarrjes së P.Gj në protestën e cilësuar si të paligjshme, organizuar nga banorët e Njësisë Administrative Fan, Mirditë.

Pozicioni i punës së P.Gj, si gazetar, konsiston në mbulimin mediatik të ngjarjeve që ndodhin në terren. Detyrat profesionale që i caktohen atij nga redaksia e televizionit, në favor të së cilit

¹ Referuar Prokurës së Përgjithshme nr. Rep. 1387, kol 481, datë 15.06.2021.

² Për shkak të profesionit si gazetar kritik.

ofronte shërbimin, lidhen me pasqyrimin e dinamikës e zhvillimit të ngjarjeve të ndryshme apo edhe aktiviteteve të tjera të cilat duhen të mbulohen profesionalisht në kuadër të misionit të mediave për raportimin e ngjarjeve me interes për publikun.

Në datë 11.04.2021, gazetari P.Gj ka qenë duke përmbushur detyrën. Ai ka qenë duke raportuar ecurinë e protestës që po zhvillohej nga banorët e Njësisë Administrative Fan, pranë Tunelit të Kalimashit. Mbulimi mediatik i këtij zhvillimi i është caktuar detyrë nga redaksia. Raportimi i bërë nga P.Gj vërtetohet lehtësisht nga transmetimi i bërë në Televizionin “Fax News” në po këtë datë. Gjithashtu fakti që ky shtetas ka qenë duke zbatuar direktivat e televizionit, konstatohet edhe nga komunikimet në WhatsApp me eprorin e tij, i cili i jep udhëzimet e nevojshme mbi realizimin e detyrës dhe mbulimin mediatik të ngjarjes.

Po në këtë datë, ky shtetas është ndaluar nga patrulla e policisë Lezhë në zonën e mbikalimit të Gjocit Mirditë, pavarësisht se njëhej publikisht si gazetar, me motivin e pjesëmarrjes në protestën e paligjshme të realizuar në fshatin Fan, Mirditë.

Menjëherë pas ndalimit, është bërë shoqërimi tij në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë. Të dhënat e mësipërme faktohen edhe nga shkresa kthim-përgjigje nr. 2851/3, datë 22.06.2021 e përcjellë nga DVP Lezhë sipas të cilës: “Shtetasi P.Gj u ndalua tek mbikalimi i Gjocit Mirditë, për arsye se dyshohet për pjesëmarrje në një protestë të paligjshme në fshatin Fan Mirditë, dhe u shoqërua në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë, pa probleme”.

P.Gj prej vitesh ushtronte profesionin e gazetarit. Detyra e tij konsistonon në mbulimin mediatik të ngjarjeve që ndodhin në terren. Ai respektonte detyrat mediatike për pasqyrimin e lajmeve në zonën që mbulonte, sipas porosive që i caktohen atij nga redaksia në favor të së cilës ofronte shërbimin. Sipas dinamikës së zhvillimit të ngjarjeve në datë 11.04.2021, gazetari P.Gj ka qenë në krye të detyrës duke raportuar ecurinë e protestës që po zhvillohej nga banorët e Njësisë Administrative Fan, pranë Tunelit të Kalimashit. Raportimi i bërë nga P.Gj vërtetohet lehtësisht nga transmetimi i bërë në Televizionin “Fax News” në po këtë datë. Ai nuk ka qenë pjesë e protestës si qytetar, por në përmbushje të misionit të tij si gazetar. Në cilësinë e provës, do të depozitohet pamje filmike por edhe komunikime nëpërmjet platformës WhatsApp të gazetarit P.Gj me redaksinë e televizionit “Fax News”, ku ka marrë detyra për të mbuluar këtë protestë.

Edhe gjatë shoqërimit gazetari P.Gj ka qenë duke filmuar. Këto pamje i janë kaluar televizionit nëpërmjet platformës WhatsApp, në kanalën zyrtar të komunikimit të redaksisë. Diçka e tillë në radhë të parë provon faktin se gazetari P.Gj ka qenë prezent në protestë në përmbushje të detyrave të tij, të cilat i janë ngarkuar nga redaksia. Nga situata konkrete rezulton se për shkakë diskriminuese, punonjësit e Policisë së Shtetit kanë cënuar të drejtën e gazetarit P.Gj për ushtrimin e profesionit të gazetarit si dhe të drejtën e medias ku ai punonte për të transmetuar lirisht lajmet me interes për publikun.

Për shkak të veprimtarisë së hershme si gazetar në këtë zonë, punonjësit e Policisë së Shtetit kanë pasur mundësi ta identifikonin. Një mundësi e tillë ka ekzistuar edhe në momentin e akomodimit të tij në ambientet e Policisë Lezhë. P.Gj ka treguar se ai është gazetar dhe se

aksesimi i protestës ka qenë për arsye të mbulimit të saj mediatik. Ai ka qenë i pajisur me mjetet e identifikimit të gazetarit. Kjo nuk e ka penguar Policinë e Shtetit të bëjë shoqërimin e tij. Menjëherë pas ndalimit, është bërë shoqërimi i tij në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë. Të dhënat e mësipërme faktohen edhe nga shkresa kthim-përgjigje nr. 2851/3, datë 22.06.2021 e përcjellë nga DVP Lezhë. Kjo shkresë tregon se Policia e Shtetit nuk mban parasysh faktin se P.Gj është gazetar dhe në momentin e zhvillimit të protestës ai ka qenë duke përmbushur detyrën.

P.Gj në momentin e ndalimit, është prezantuar si gazetar duke paraqitur mjetin e identifikimit të gazetarit dhe njëkohësisht ka pasur me vete mjetet e domosdoshme, të nevojshme për raportim (kamera dhe mikrofon). Megjithatë, nga ana e Policisë Lezhë, përveçse nuk është mbajtur parasysh statusi i tij si gazetar dhe qëllimi pse ai ndodhej në vendin e organizimit të protestës, qëllimisht nuk është mbajtur një procesverbal për sendet që dispononte i shoqëruari. Sipas qëndrimit të gazetarit P.Gj, mungesa e një procesverbali mbi sendet që i janë konstatuar, është bërë me synimin e vetëm për të kamufluar statusin e tij në mënyrë që të konsiderohet shoqërim i një shtetasi të thjeshtë dhe jo shoqërim i një gazetari, kjo pasi atij i janë marrë përkohësisht kamera dhe mikrofoni.

Gjithashtu, nga sa bëhet me dije nga ankuesi, nga ana e policisë nuk i është dhënë mundësia e nënshkrimit të një procesverbali të veprimeve të kryera me të shoqëruarin.

Ndalimi i gazetarit është bërë në një zonë e cila është 40 km larg nga vendi i mbajtjes së protestës nga banorët e Njësisë Administrative Fan. Referuar këtij momenti, gazetari nuk është ndaluar në “vendin e ngjarjes” ku ka ndodhur protesta. Gazetari është shoqëruar në mënyrë të paligjshme dhe arsyetimi zyrtar “për pjesëmarrje në protestë të paligjshme”, është formal dhe nuk ekziston realisht.

Ky fakt mbështetet edhe nga fakti se gazetari rezulton të jetë me vendbanim në Bashkinë Lezhë dhe se nuk ka qenë as banues i përhershëm apo i përkohshëm i asaj njësie administrative, ku u zhvillua protesta. Diçka e tillë e përjashton në mënyrë kategorike interesin e tij të drejtëpërdrejtë apo indirekt për pjesëmarrjen në protestë, pasi ndërtimi ose jo i HEC-it në Fan, nuk prekte as drejtëpërdrejtë dhe as tërthorazi interesin personal apo pasuror të personit, apo të afërmeve të tij.

Theksojmë se pjesëmarrës në këtë protestë në cilësinë e raportuesve kanë qenë edhe gazetarë të tjerë. Asnjëri prej tyre nuk është shoqëruar nga ana e policisë por është bërë dallim vetëm për P.Gj. Prezenca e gazetarëve të tjerë vërtetohet lehtësisht nga kronikat e realizuara në atë ditë dhe të transmetuara nëpërmjet kanaleve televizive.

Një pikë kyçe shumë e rëndësishme është edhe mënyra e sjelljes dhe e qasjes së policisë së Komisarariatit të Lezhës me gazetarin, në dallim nga të shoqëruarit e tjerë shtetas të thjeshtë të cilët kanë qenë më shumë se 20 persona. Lirimi i tij, afro 4-5 orë përpara lirim të shtetasve të tjerë dhe pas bërjes publike në media të lajmit të shoqërim të tij, për më tepër pa zbatuar procedurat ligjore ndaj tij, lë vend për dyshime se strukturat e policisë kanë dashur të fshehin fakte dhe rrethana me rëndësi për këtë rast.

Lirimi i gazetarit përpara personave të tjerë të shoqëruar dhe pa dokumentuar veprimet procedurale të kryera ndaj tij sjell lindjen e dyshimit së shoqërimi i tij ka ndodhur me qëllime të tjera, të lidhura me profesionin e tij. Pengimi i ushtrimit të profesionit ka qenë qëllimi real i shoqërimin të tij nga punonjësit e policisë. Kjo sjell një situatë diskriminuese e cila lidhet me qëllimin final për ta penguar atë në ushtrimin e detyrës. Pra sikurse u argumentua dhe më lart, ndalimi që i'u bë gazetarit i kufizoi atij të drejtën për të raportuar ngjarjen e saponodhur që përkon me "pas protestës, pjesëmarrësit u shoqëruan në polici". Kjo ngjarje u raportua nga mediat e tjera por gazetarit të Fax News në pamundësi objektive dhe diskriminuese i'u mohua kjo e drejtë.

Duke e vendosur situatën në një plan më të gjerë, duke prezumuar se vërtetë ka ekzistuar një dyshim i arsyeshëm për shoqërimin e tij në polici, me të drejtë vetë gazetarit i lind pyetja se cila është arsyeja që ndalimi është bërë vetëm për këtë gazetar dhe jo edhe për gazetarët e tjerë të cilët kanë qenë duke raportuar në terren. Kjo e bën P.Gj të ndihet i disfavorizuar dhe i trajtuar ndryshe në raport me kolegët e tij të tjerë".

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të gazetarit P.Gj, si rezultat i shoqërimin të tij nga ana e Policisë së Shtetit në mënyrë të padrejtë dhe të pa motivuar ligjërisht, në të drejtën për të ushtruar lirisht profesionin e gazetarit dhe duke cenuar lirinë e medias, për shkak të bindjeve politike, linjës kritike të televizionit ku punonte dhe për shkaqe të tjera.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: "Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim".

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010, i ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 344/2, datë 20.03.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga subjekti, për ankesën e bërë nga P.Gj si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
 - Kopje të listës dhe dokumentacionit të veprimeve proceduralë të mbajtur nga punonjësit e policisë, të personave të shoqëruar si të dyshuar për pjesëmarrjen në protestën e organizuar në fshatin Fan Mirditë, në datë 11.04.2021 dhe procedurën e lirit të tyre.
 - Informacion nëse ka pasur dhe gazetarë të tjerë të shoqëruar, në ngjarjen objekt shqyrtimi.
 - Informacion nëse çështja objekt shqyrtimi është trajtuar në gjykatë. Nëse po, kopje të vendimit të gjykatës, nëse ka.

Me shkresën nr. 1690/1, datë 26.04.2023, Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Shtetasi P.Gj në datë 11.04.2021 është shoqëruar nga punonjësit e policisë së Komisarariatit të Policisë Mirditë në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë, gjë për të cilën është përpiluar Raport Shërbimi nga punonjësi i policisë, Inspektor P.Ll. Në Raportin e Shërbimit lexohet tekstualisht se: “Shtetasi P.Gj u ndalua tek mbikalimi i Gjocit-Mirditë, për arsye që dyshohet për pjesëmarrje në një protestë të paligjshme në fshatin Fan-Mirditë, u shoqërua në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë pa probleme”.*

Shoqërimi i shtetasit të lartpërmendur në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë është pasqyruar në librin e “Hyrje-Daljeve” të personave në institucion dhe pas verifikimeve të kryera nga ku rezultoi se shtetasi në fjalë ishte gazetar nuk është futur në dhomat e shoqërimit/ndalimit por ka qëndruar në ambiente jashtë këtyre dhomave dhe më pas është lënë i lirë. Pretendimet e shtetasit P.Gj se është ndaluar të përmbushë detyrën e gazetarit bien poshtë për faktin se siç theksohet në faqen 3 (tre) në paragrafin 4 (katër) të shkresës Tuaj nr. 334/2, datë 20.03.2023, se: “Ndalimi i gazetarit është bërë në një zonë e cila është 40 km larg nga vendi i mbajtjes së protestës nga banorët e Njesisë Administrative Fan, etj, etj”, pra gazetari është

ndaluar pas përfundimit të protestës dhe nuk është penguar në kryerje e sipër të misionit të tij, gjithashtu atij nuk i është marrë asnjë nga mjetet e tij të punës, kamera, telefon apo çdo pajisje tjetër që mund të ketë patur me vete. Me datën 11.04.2021 për protestën e paligjshme në fshatin Fan janë shoqëruar disa shtetas të tjerë, disa prej të cilëve janë arrestuar e disa të tjerë janë ndjekur penalisht në “gjendje të lirë”, gazetarë të tjerë të shoqëruar/ndaluar nuk ka patur. Për shtetasin P.Gj nuk ka filluar Procedim Penal dhe çështja për të nuk është trajtuar në Gjykatë”.

Me e-mail-in datë 11.04.2023, Inspektori i çështjes ka vënë në dijeni subjektin ankues, lidhur me përgjigjen e dhënë nga DVP Lezhë.

Me e-mail-in datë 20.04.2023, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ka dërguar parashtrime, lidhur me çështjen, në të cilën në mes të tjerash ka informuar se:

“1. Në qëndrimin e tij përpara Komisionerit, me anën e shkresës nr. 1690/1, datë 06.04.2023, DVP Lezhë, thekson se: “gazetarë të tjerë të shoqëruar/ndaluar nuk ka patur”.

Nga qëndrimi zyrtar i DVP Lezhë konfirmohet pretendimi i ankuesit, se ai ka qenë i vetmi gazetar i shoqëruar nga Policia e Shtetit, pavarësisht se ka kryer të njëjtën detyrë si edhe gazetarë të tjerë. Ky është një element i rëndësishëm i cili tregon se shoqërimi i P.Gj ka ndodhur për shkaqe diskriminuese dhe jo me synimin e zbatimit të ligjit.

2. Një fakt rëndues, i cili hedh dritë mbi ekzistencën e shkaqeve diskriminuese në këtë rast është edhe konfirmimi zyrtar i DVP Lezhë kur ajo pranon se: “Pas verifikimeve të kryera rezultoi se shtetasi në fjalë ishte gazetar dhe nuk është futur në dhomat e shoqërimit/ndalimit por ka qëndruar në ambiente jashtë këtyre dhomave”.

Kjo tregon se Policia e Shtetit e ka patur informacionin se qytetari i shoqëruar ka qenë gazetar. Kjo dijeni e policisë mbi statusin e personit të shoqëruar, parë në lidhje me faktin se ai ka qenë duke mbuluar mediatikisht një tubim, shton peshën e përgjegjësisë dhe hedh dritë mbi shkaqet e vërteta të këtij veprimi. Neni 109 i Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, ofron të njëjtën garanci me nenin 5/1 të KEDNj dhe specifikisht përcakton se: “1. Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme: c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer vepër penale”.

Në shkresën nr. 1690/1, datë 06.04.2023 drejtuar Komisionerit, nga DVP Lezhë theksohet se: “Shtetasi P.Gj u ndalua tek mbikalimi i Gjocit-Mirditë, për arsye që dyshohet për pjesëmarrje në një protestë të paligjshme në fshatin Fan-Mirditë, u shoqërua në ambientet e Komisariatit të Policisë Lezhë pa probleme”.

Kujtojmë këtu parashikimet e nenit 4 të Ligjit nr. 8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet” i cili në mënyrë të qartë dhe të pakontestueshme thekson të drejtën që kanë përfaqësuesit e mediave të jenë të pranishëm gjatë zhvillimit të tubimeve dhe nuk mund të përjashtohen nga askush gjatë zhvillimit të tij.

Pra, shkak i shoqërimit të gazetarit P.Gj për “pjesëmarrje në një protestë të paligjshme” është i pa bazuar në ligj, pasi neni 4 i ligjit nr. 8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet” u nje gazetareve të drejtën që në kuadër të misionit të tyre të marrin pjesë në organizime të tilla. Pjesëmarrja e gazetarit P.Gj në këtë tubim, ka qenë në kuadër të detyrës së tij dhe për këtë ne kemi depozituar provat përkatëse, bashkëlidhur ankesës. Kjo hedh dritë se shoqërimi i këtij shtetasi nga Policia e Shtetit ka ndodhur për shkaqe diskriminuese.

3. Konfirmimi zyrtar i DVP Lezhë se: “nuk është futur në dhomat e shoqërimit/ndalimit por ka qëndruar në ambiente jashtë këtyre dhomave” në vetvete përbën një shkelje të rëndë. Kjo tregon se shkak i vërtetë se pse gazetari është shoqëruar, nuk lidhet me zbatimin e ligjit, pasi në këtë rast do të ishte zbatuar në mënyrë rigoroz procedurë standard e miratuar. Qëllimi se pse gazetari është shoqëruar lidhet me shkaqe diskriminuese, për shkak të punës që ai bën.

Referuar pikës 4, Kreu VII të Urdhrit nr. 938 datë 24.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për procedurat standarde të punës për: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit” parashikohet se:

“a. Personat e shoqëruar mbahen në mjedise e ambiente me kushte të ndryshme nga ato që shërbejnë për mbajtjen e personave të arrestuar/ndaluar (dhomat e sigurisë).

c. Mjediset të jenë me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin e personave, të jenë të lyera, të pastra nga ana higjienike, si dhe të kenë dritare me përmasa të tilla që të krijojnë mundësi për realizimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral.

d. Në mjediset ku pyetet i shoqëruari të kenë të vendosura pajisje e orendi pune për specialistët, e ndihmës specialistët e policisë, si: tavolina, karrige, si dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilat të jenë të fiksuara dhe të pa lëvizshme”.

Në shkelje të këtij parashikimi ligjor, gazetari P.Gj ashtu si pranon zyrtarisht DVP Lezhë se: “nuk është futur në dhomat e shoqërimit/ndalimit por ka qëndruar në ambiente jashtë këtyre dhomave”. Kjo përbën shkelje të rëndë të pikës 4 Kreu VII të Urdhrit nr. 938, datë 24.07.2019, mbi kushtet e mbajtjes dhe sigurinë për personat e shoqëruar. Sipas asaj që tregon gazetari P.Gj është mbajtur në hapësirën poshtë shkallëve të Komisarariatit. Një element i tillë jep të dhëna se shkaqet e shoqërimit janë diskriminuese dhe në thelb kanë patur qëllimin për të ndaluar apo frikësuar gazetarin në përmbushjen e detyrës së tij.

4. DVP Lezhë konfirmon se: “Shoqërimi i shtetasit të lartpërmendur në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë është pasqyruar në “Librin e Hyrje-Daljeve” dhe është hartuar “Raporti i Shoqërimit”. Dokumente të tjera nuk janë hartuar për këtë rast dhe kjo sjell mangësi themelore në zbatimin e procedurës së shoqërimit dhe ngre dyshime se veprimet e Policisë së Shtetit janë kryer mbi shkaqe diskriminimi.

Sipas qëndrimit të gazetarit P.Gj, mungesa e një procesverbali mbi sendet që i janë konstatuar, është bërë me synimin e vetëm për të kamufluar statusin e tij, në mënyrë që të konsiderohet

shoqërim i një shtetasi të thjeshtë dhe jo shoqërim i një gazetari, kjo pasi atij i janë marrë përkohësisht kamera dhe mikrofoni.

Gjithashtu, nga sa bëhet me dije nga ankuesi, nga ana e policisë nuk i është dhënë mundësia e nënshkrimit të një procesverbali të veprimeve të kryera me të shoqëruarin. Ky fakt është lehtësisht i vërtetueshëm pasi dhe në shkresën kthim përgjigje të sipërcituar, nuk gjenden të bashkëlidhura procesverbalet respektive. Nuk mendohet që kjo të jetë një harresë procedurale apo profesionale duke marrë parasysh detyrimin që kanë strukturat e policisë në zbatimin e ligjit material dhe procedural, por edhe nga eksperiencia e mëparshme e personave që kanë bërë shoqërimin e gazetarit. I vetmi deduksion që rrjedh nga kjo situatë, është se çdo gjë është bërë në mënyrë të qëllimshme, në shkelje të Kushtetutës, Konventës dhe ligjeve specifike dhe se situata e gazetarit ka tiparet e diskriminimit të drejtpërdrejtë. Sipas parashikimeve të nenit 109 pika 5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.

Kreu VIII “Procedura të dokumentimit të veprimit të shoqërimit” pika “a.3” e Urdhrit, nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Rregullat teknike të shoqërimin në mjediset e Policisë së Shtetit”, parashikon se pas kryerjes së veprimeve të verifikimit e sqarimit të rastit për personin e shoqëruar, nga punonjësi i policisë hartohet procesverbali i dokumentimit të veprimeve të kryera me personin e shoqëruar. Për më tepër referuar lidhjes nr. 3 të këtij Urdhri, përkatësisht “Procesverbal i veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar”, në një rubrikë të caktuar ka edhe “Kthimi i sendeve personale të bllokuara përkohësisht”.

Mungesa e këtij dokumentacioni, dhe veprimeve procedurale të cilat do të sillnin zbatimin e saktë të shoqërimin, në vlerësimin tonë përbëjnë shkak vërtetues për diskriminimin ndaj gazetarit P.Gj. Punonjësit e Policisë së shtetit kanë vepruar në mënyrë jo të saktë, e kjo ka shërbyer si shkak për trajtimin diskriminues ndaj gazetarit P.Gj. Kjo hedh dritë se gazetari është shoqëruar pa një shkak të ligjshëm, por për shkaqe diskriminuese të cilat lidhen me element diskriminues.

5. DVP Lezhë thekson se: “Ndalimi i gazetarit është bërë në një zonë e cila është 40 km larg nga vendi i mbajtjes së protestës nga banorët e Njësisë Administrative Fan”.

Gazetari nuk është ndaluar në “vendin e ngjarjes” ku ka ndodhur protesta. Për pasojë sa vjen dhe shtohet dyshimi se shoqërimi i tij në themel sjell diskriminimin e gazetarit. Gazetari është shoqëruar në mënyrë të paligjshme dhe arsyetimi zyrtar “për pjesëmarrje në protestë të paligjshme”, është formal dhe nuk ekziston realisht.

Kjo indicie mbështetet faktin se gazetari rezulton të jetë me vendbanim në Bashkinë Lezhë, dhe se nuk ka qenë as banues i përhershëm apo i përkohshëm i asaj njësie administrative, ku u zhvillua protesta. Diçka e tillë përjashton në mënyrë kategorike interesin e tij të drejtpërdrejtë apo

indirekt për pjesëmarrjen në protestë pasi ndërtimi ose jo i HEC-it në Fan, nuk prekte as drejtpërdrejtë dhe as tërthorazi interesat personal apo pasuror të personit, apo të afërmeve të tij”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 334/4, datë 22.05.2023 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 09.06.2023³, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e palëve në proces: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i përfaqësuar nga E.M dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesit të DVP Lezhë G.L.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i ankuesit i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe deklaroi⁴ se: *“P.Gj është një gazetar që ka punuar si korrespondent lokal për një sërë televizionesh në Qarkun e Lezhës. Gjithmonë qasja e tij ka qenë opozitare, pra raportimet që bënte kanë qenë të një spektri investigativ kritik, në ngritjen e problematikave të ndryshme dhe ka pasur profilin e një gazetari në krahun e opozitës, jo opozitës politike por të një oponenti, i cili nëpërmjet kësaj qasje ngrinte problematika të ndryshme. Kjo përforcohet dhe nga fakti se televizioni ku punonte kishte një linjë editoriale të tillë ku fokusi i kësaj medie dhe gazetarit ka qenë evidentimi i problematikave të ndryshme në nivel lokal, ky ka qenë dhe shkaku përse është shoqëruar. Gazetari po kthehej me një mjet të transportit publik dhe nga pamjet duken shumë persona dhe janë shoqëruar dhe shtetas të tjerë që janë në furgon, të cilët kanë qëndruar më gjatë në komisariat. Në tubim ka pasur dhe gazetarë të tjerë dhe mund të jenë të mediave kritike, por është e rëndësishme dhe rrethanat dhe vendi ku ka ndodhur ngjarja. Në mjetin e transportit publik vetëm P.Gj ka qenë gazetar por në mjetet e tjera ka pasur dhe gazetarë të tjerë që janë kthyer në Lezhë, por asnjë gazetar tjetër nuk është shoqëruar. P.Gj në momentin e parë e ka pasur celularin, por pastaj i është marrë”.*

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i DVP Lezhë dorëzoi prapësimet me shkrim, në të cilin informoi se: *“Shtetasi P.Gj me datën 11.04.2021 është shoqëruar nga punonjësit e policisë së Komisarariatit të Policisë Mirditë në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë, gjë për të cilën është përpiluar Raport Shërbimi nga punonjësi i policisë Inspektor P.Ll dhe është mbajtur në ambientet policore nga ora 13:45 deri në orën 17:45.*

³ Seanca e planifikuar për tu zhvilluar në datë 02.06.2023, me kërkesë të përfaqësuesit të DVP Lezhë, u dakordësua nga palët, për tu zhvilluar në datë 09.06.2023.

⁴ Referuar deklaramëve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 07.20 e në vijim.

Në Raportin e Shërbimit lexohet tekstualisht se: “Shtetasi P.Gj u ndalua tek mbikalimi i Gjocit-Mirditë, për arsye që dyshohet për pjesëmarrje në një protestë të paligjshme në fshatin Fan-Mirditë, u shoqërua në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë pa probleme”.

Shoqërimi i shtetasit të lartpërmendur në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë është pasqyruar në librin e “Hyrje-Daljeve” të personave në institucion dhe pas verifikimeve të kryera nga ku rezultoi se shtetasi në fjalë ishte gazetar, nuk është futur në dhomat e shoqërimit/ndalimit por ka qëndruar në ambiente jashtë këtyre dhomave dhe më pas është lënë i lirë.

Pretendimet e shtetasit P.Gj se është ndaluar të përmbushë detyrën e gazetarit bien poshtë për faktin se siç theksohet në faqen 3 (tre) në paragrafin 4 (katër) të shkresës Tuaj nr. 334/2, datë 20.03.2023, se: “Ndalimi i gazetarit është bërë në një zonë e cila është 40 km larg nga vendi i mbajtjes së protestës nga banorët e Njësisë Administrative Fan, etj, etj”, pra gazetari është ndaluar pas përfundimit të protestës dhe nuk është penguar në kryerje e sipër të misionit të tij, gjithashtu atij nuk i është marrë asnjë nga mjetet e tij të punës, kamera, telefon apo çdo pajisje tjetër që mund të ketë patur me vete. Theksoj që personi në fjalë nuk ka treguar asnjë dokument gazetari dhe as ka pasur të tillë të dukshëm.

Ndër të tjera aty kanë qenë prezent shumë gazetarë të mediave audio-vizive të cilët kanë kryer detyrën dhe nuk janë shoqëruar apo ndaluar nga policia. Nuk ka sesi të quhet diskriminim puna e kryer nga punonjësit e policisë mbi verifikimin e shtetasve (në rastin konkret P.Gj) ku në asnjë moment nuk është ndaluar në dhomat e shoqërimit/ndalimit, por vetëm ka qëndruar në ambientet, korridorin e pritjes së qytetarëve deri sa është identifikuar. Ndaj personit në fjalë nuk janë referuar materiale në prokurori dhe nuk është arrestuar, por thjeshtë ka qëndruar në ambientet e jashtme.

Përsa i takon personave të tjerë në komunikatë rezulton që: Me datën 11.04.2021 për protestën e paligjshme në fshatin Fan-Mirditë janë shoqëruar dhe kryer veprime procedurale e janë ndjekur penalisht në “gjendje të lirë”, shtetasit e poshtëshënuar:

- *Me datë 11.04.2021, ora 20:00, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve: B.P, E.B dhe Ç.B dhe u referuan materialet në ngarkim të shtetasve: cituar 30 persona, sepse me datën 11.04.2021, nga ora 09:30 deri ora 12:30, në superstradën Milot-Morinë, në hyrje të tunelit të Thirrës, në bashkëpunim me persona të tjerë, kanë organizuar dhe kanë marrë pjesë në një protestë të paligjshme që po zhvillohej për pengimin e ndërtimit të një Hidrocentrali në fshatin Sang-Fan, Mirditë dhe për disa minuta kanë penguar lëvizjen e mjeteve të transportit, duke kundërshtuar me dhunë dhe duke mos iu bindur urdhrave të ligjshëm të punonjësve të rendit publik.*

Për shtetasin P.Gj nuk ka filluar Procedim Penal dhe çështja për të nuk është trajtuar në Gjykatë dhe nuk ka pasur gazetarë të tjerë të shoqëruar/ndaluar. Sa më lart kërkojmë që të verifikohet nëse shtetasi P.Gj është apo jo i regjistruar si gazetar pranë mediave audio-vizive, dhe kërkojmë që kjo ankesë e tij të trajtohet sa më paanshmërisht duke qenë se personi në fjalë

nuk është hera e parë që nxjerr problematika të tilla karshi punës së punonjësve të policisë së shtetit duke cenuar figurën e pastër të tyre. Është i paprecedent fakti që personi pretendon të jetë diskriminuar vetëm sepse policia ka bërë detyrën duke shoqëruar shtetasit pas bllokimit të rrugës nacionale dhe kundërshtimit me dhunë nga ana e uzurpuesve të rrugës, ku për më tepër ankuesi vetëm është shoqëruar dhe jo ndaluar në dhomat e shoqërimit.

Përsa i takon pretendimit që si gazetar i hershëm në këtë zonë punonjësit duhej ta identifikonin, nuk është e vërtetë, pasi gazetarët duhet të kenë mjetin e tyre të identifikimit, të kryejnë detyrën dhe jo të uzurpojnë rrugën apo kundërshtojnë forcat e policisë”.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i DVP Lezhë i qëndroi të njëjtave parashtime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe deklaroi⁵ se: “Kishim informata që në furgon kishte persona që kanë ushtruar dhunë ndaj punonjësve të policisë, që kanë thyer rregullat e gjendjes së jashtëzakonshme për masat kundër Covid-19. Z. P.Gj nuk është një gazetar që njihet në zonë nga komuniteti, por unë e njoh për arsye se në stadiumet ku ka luajtur “Besëlidhja” ka qenë konfliktual me punonjësit e policisë, është person problematik, është person që nuk figuron si gazetar. Në Lezhë mund të njihet si person, por në Mirditë nuk njihet. Sipas komunikimeve ankuesi nuk është në punë dhe nuk e dimë a ka qenë me mjetin e identifikimit të gazetarit kur është ndaluar. Çdo gazetar që shkon në vendngjarje ka mjetin e tij me stemën ‘press’ dhe logon e televizionit që përfaqëson si gazetar. Në rastin konkret nuk kemi një shoqërim të mirëfilltë, pasi shoqërimi nënkupton shoqërim në dhomat e ndalim/shoqërimit në dhomat e Komisarariatit ose të marrjes në pyetje. Ankuesi në momentin e ndalimit ka qenë i shoqëruar me persona problematikë të cilët janë dënuar penalisht dhe administrativisht për këtë gjë. Ankuesi është marrë në ambientet jo të brendshme të policisë, por në paradhomën që shërben për çdo person që marrin pasaportat, informacione, etj. P.Gj nuk ka bërë asnjë ankesë për trajtimin nga ana e punonjësve të policisë”.

Në vijim të seancës dëgjimore, përfaqësuesi i DVP Lezhë, me e-mail-in datë 11.07.2023, informoi Komisionerin si më poshtë:

“ - Përsa i takon pyetjes si është bërë shoqërimi dhe mjete me të cilin është shoqëruar P.Gj ju bëjmë me dije se:

Gjatë protestës së zhvilluar në mënyrë të dhunshme nga protestuesit duke bllokuar aksin rrugor dhe goditur punonjësit e policisë, menjëherë në mbarim të saj, në bazë të informacioneve të mbledhura, është bërë identifikimi, lokalizimi dhe shoqërimi i personave të dhunshëm ku në një nga mjetet që po lëviznin ishte edhe personi në fjalë. Duke qenë se numri i tyre ishte i lartë një pjesë e protestuesve u dërguan me mjete policie pranë ambienteve të Komisarariatit të Policisë Lezhë për t’u verifikuar.

Shoqërimi pranë ambienteve është kryer në zbatim të nenit 109 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, nr.108/2014, sipas pikës 1, germa c, si dhe në përcaktim të pikës 2 të po këtij neni, nuk mund të

⁵ Referuar deklaramëve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 34.10 e në vijim.

mbahej më shumë se 10 orë nga momenti i shoqërimit. Pas intervistimit u bë i mundur identifikimi i tij dhe u la i lirë. Theksoj se ndaj tij nuk ka nisur procedim penal, ndërsa personat e tjerë janë ndaluar dhe proceduar penalisht ku tashmë kemi edhe vendime penale gjyqësore në ngarkim të tyre.

- *Pse nuk ka një procesverbal të mbajtur për sendet e sekuestruara?*

Nuk është mbajtur asnjë procesverbal pasi ai nuk ka qenë i ndaluar/shoqëruar në dhomat e ndalim/shoqërimit si dhe asnjë nga sendet e tij personale nuk i është mbajtur.

- *Në bazë të çfarë urdhëri është shoqëruar?*

Përsa i takon rastit në fjalë është kryer në bazë të informacioneve policore të dokumentuara”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstronhet se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohej diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.*

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar ndonjë trajtimi të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në lidhje me shoqërimin në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezultojnë se:

Në datë 11.04.2021, nga ora 09:30 deri ora 12:30, në superstradën Milot-Morinë, në hyrje të tunelit të Thirrës (Kalimash) është zhvilluar një protestë kundër ndërtimit të një Hidrocentrali në fshatin Sang-Fan, Mirditë.

Referuar komunikimeve të gazetarit P.Gj me redaksinë e televizionit Fax News rezultojnë se ankuesi ka qenë në vendin e protestës dhe ka raportuar ngjarjen. Pas mbarimit të protestës, P.Gj ka qenë duke u kthyer në Lezhë me një mjet të transportit publik (mikrobus). Rreth 40 km nga vendi i organizimit të protestës, mjeti i transportit ku udhëtonte ankuesi është ndaluar nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Mirditë dhe pasagjerët së bashku me ankuesin, janë shoqëruar për në mjediset e Komisarariatit të Policisë Lezhë.

Referuar Formularit të Raportit të Shoqërimit ose Ndalim/Arrestimit, të mbajtur në orën 14.05, nga Inspektori i Komisarariatit të Policisë Mirditë, z. P. Ll, shpjegohet arsyeja e shoqërimit të ankuesit, në të cilën rezultojnë se: *“Shtetasi P.Gj u ndalua tek mbikalimi i Gjocit Mirditë, për arsye që dyshohet për pjesëmarrje në një protestë të paligjshme në fshatin Fan Mirditë. U shoqërua në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë. Pa probleme”.*

Referuar librit të Hyrje-Dalje të Personave në Institucion, të Komisarariatit të Policisë Lezhë, figuron se P.Gj është paraqitur në orën 13.45 dhe ka dalë në orën 17.45.

Ligji 8773/2001 *“Për tubimet”*, në nenin 4, ka parashikuar se: *“1. Përfaqësuesit e medias kanë të drejtë të jenë të pranishëm gjatë tubimit dhe nuk mund të përjashtohen nga askush gjatë zhvillimit të tij. 2. Përfaqësuesit e medias duhet të jenë të pajisur me kartën e anëtarësisë së medias. 3. Prania e përfaqësuesve të medias gjatë tubimit u bëhet e ditur në çdo kohë forcave të policisë që ndjekin zhvillimin e tubimit”,* ndërsa në nenin 13 ka parashikuar se: *“Drejtuesi i tubimit dhe organizatorët e tij vendosin se cilët persona do të ndjekin tubimin, përveç përfaqësuesve të medias të cilët, në asnjë rast, nuk mund të përjashtohen”.*

Referuar deklaratave të palëve, rezultojnë se gazetari P.Gj, gjatë zhvillimit të protestës nuk është penguar për të kryer detyrën e tij për raportimin e ngjarjes dhe nuk ka pasur ndonjë ankesë ndaj punonjësve të policisë. Pretendimet e ankuesit janë rreth situatës së shoqërimit të tij pas protestës dhe mbajtjes së tij për verifikim në mjediset e Komisarariatit të Policisë Lezhë për rreth 4 orë.

Si rezultat i zhvillimit të kësaj proteste, strukturat e Policisë së Shtetit kanë bërë shoqërimin e 33 personave dhe të z. P.Gj në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë, në përputhje me nenin 6, pika 25 dhe nenin 109 të ligjit nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: *“Neni 6, “Përkufizime”. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:*

...25. “Shoqërimi” është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit, te kujdestari ose personi përgjegjës, në institucionin urdhërdhënës ose në institucionet e tjera me ose pa vullnetin e tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122, pika 1, të këtij ligji”.

Neni 109, Shoqërimi në polici.

1. Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme: a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente; b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose ndonjë detyrimi të përcaktuar me ligj; c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer veprë penale; ç) për të parandaluar kryerjen e një veprë penale; d) kur është larguar pas kryerjes së një veprë penale; dh) për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale; e) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose shoqërimin e tij në organin kompetent; ë) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paafte mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë; f) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit.

2. Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë.

3. Personi i shoqëruar ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e shoqërimit. Ai/ajo duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar dhe avokatin.

4. Efektivi i policisë njofton menjëherë qendrën operative për gjeneralitetet e personit të shoqëruar, kur ato njihen, orën e saktë të shoqërimit dhe shkaqet e tij. Të dhënat e komunikuar nga efektivi i policisë hidhen menjëherë në sistemin elektronik të mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave. Mosrespektimi nga efektivi i policisë i detyrimeve të përcaktuara në këtë pikë përbën shkelje të rëndë të disiplinës në punë.

5. Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.

6. Punonjësi i policisë ka detyrimin të njoftojë menjëherë eprorin e vet ose institucionin e interesuar për sqarimin e çështjes. Të dhënat e veprimeve të kryera me personat e shoqëruar dokumentohen gjithashtu në regjistrat/librat që mbahen për këtë qëllim në ambientet e policisë ku është bërë shoqërimi i personit”.

Në zbatim të ligjit të sipërcituar, me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Policisë së Shtetit, janë hartuar procedurat standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, në të cilin parashikohet se: “Shoqërimi” është veprimi administrativ, me karakter detyrues (me ose pa vullnetin e personit që shoqërohet) dhe shtrëngues (qoftë edhe forcërisht), që

kryhet nga punonjësi i policisë për dërgimin e shtetasit në ambientet e policisë apo në institucionet e tjera, sipas përcaktimeve dhe procedurave të parashikuara me ligj e aktet nënligjore”.

Në kreu V, Rastet dhe Qëllimet e Aplikimit të Shoqërimit, parashikohet se: *“Akti/veprimi i shoqërimit të detyrueshëm si akt i shtrëngimit personal, mund të kryhet vetëm kur ekzistojnë kushtet e rastet e përcaktuara në ligj si: A. Për identifikimin e personit; B. Si masë mbrojtëse; C. Ekzekutimin e një urdhri apo detyrimi të njohur me ligj; D. Sqarimin e një rrethane”.* Ndërsa në pikën D./4 Sqarimin e një rrethane, parashikohet se: *“4.1. Të personit për të cilin ka dyshime të arsyeshme se ka kryer veprë penale; 4.2. Për të parandaluar kryerjen e një vepre penale; 4.3. Personi është larguar pas kryerjes së një vepre penale; 4.4. Personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale;...”*

Në pikën 1 të Kreut VI, të rregullores parashikohet se: *“1. Punonjësi i policisë ka të drejtë të aplikojë masën e shoqërimit dhe mbajë në mjediset e policisë një person për aq kohë sa është e domosdoshme për identifikimin apo sqarimin e rrethanave në ngarkim të tij, por jo më shumë se 10 orë”.*

Në pikën 4, Kreu VII të rregullores së sipërcituar parashikohet se: *“a. Personat e shoqëruar mbahen në mjedise e ambiente me kushte të ndryshme nga ato që shërbejnë për mbajtjen e personave të arrestuar/ndaluar (dhomat e sigurisë).”*

Në pikën a) të Kreut VIII të rregullores së sipërcituar, parashikohet se: *“a. Dokumentimi i të dhënave në rrugë manuale kryhet në: a.1 – Regjistrin e Evidentimit të të dhënave për Personat e Shoqëruar (lidhja 1); a. 2 – Formularin e Raportit të Shoqërimit (lidhja 2); a. 3 – Proces verbalin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar (lidhja 3); ndërsa në pikën a. 3 – Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar: parashikohet se: “a.3.1 - Pas kryerjes së veprimeve të verifikimit e sqarimit të rastit për personin e shoqëruar, nga punonjësi i policisë hartohet procesverbali i dokumentimit të veprimeve të kryera me personin e shoqëruar. a.3.2 – Ky procesverbal pasi plotësohet duke hedhur të gjithë të dhënat sipas përcaktimeve dhe rubrikave të përcaktuara në të, nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe nga vetë personi i shoqëruar..... a.3.4 – Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimisht personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.*

Mos plotësimi i procesverbalit dhe mos dhënia e një kopje personit të shoqëruar përbën shkelje të rëndë dhe ndëshkohet sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Policisë”.

Në pikën 4.6 të Kreut IX të rregullores së sipërcituar, parashikohet se: *“Rregullat dhe procedurat për kryerjen e kontrollit ndaj të shoqëruarve:d. Punonjësit e policisë që kanë kryer shoqërimin dorëzojnë shërbimit të informacionit dhe sendet/mjetet që mund të jenë gjetur me vete personit të shoqëruar në momentin e parë të kapjes/bllokimit në terren”.*

Në Lidhjen model nr. 3 të rregullores së sipërcituar, përkatësisht “*Procesverbal i veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar*”, në një rubrikë të saj ka parashikuar dhe evidentimin e “*Kthimi i sendeve personale të bllokuara përkohësisht*”.

Referuar kronikave/lajmeve⁶ që kanë mbuluar ngjarjen dhe deklaratave të palëve, rezulton se kjo ngjarje është raportuar nga shumë gazetarë të mediave kombëtare dhe lokale, si: Top Channel, News 24, Report Tv, Razafa Tv, ABC News, Ora News, Scan Tv, Syri Tv, etj dhe gjithashtu rezulton se asnjë gazetar i këtyre televizioneve nuk është shoqëruar në polici, si gjatë zhvillimit të protestës, ashtu dhe pas protestës, me përjashtim të P.Gj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga palët, rezulton se P.Gj ka qenë i vetmi gazetar i shoqëruar nga Policia e Shtetit, pavarësisht se ka qenë në vendin e zhvillimit të protestës (duke raportuar) dhe duke u kthyer nga vendi i ngjarjes në të njëjtën kohë si të gjithë gazetarët e tjerë, por në ndryshim me gazetarët e tjerë vetëm ky gazetar është ndaluar dhe shoqëruar për në Komisaratin e Policisë Lezhë, duke u trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me gazetarët e tjerë dhe duke i mohuar këtij të fundit dhe medias Fax News që të pasqyronte/raportonte informacionin me ngjarjet e ndodhura pas zhvillimit të protestës dhe ndalimit/shoqërimit të pjesëmarrësve në Komisariat.

Referuar “*Rregullave teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, të miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Policisë së Shtetit, Komisioneri vlerëson se e drejta e punonjësve të Policisë së Shtetit për të bërë shoqërimin e shtetasve në mjediset e organeve të policisë, rastet dhe qëllimet e aplikimit të masës së shoqërimit dhe dokumentimi i shoqërimit në polici janë parashikuar në mënyrë shumë të qartë në legjislacionin e sipërcituar dhe se shoqërimi i një shtetasi duhet të bëhet vetëm nëse ndaj tij ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale dhe duhet të dokumentohet në mënyrë të qartë dhe të saktë.

DVP Lezhë ka deklaruar se në rastin konkret nuk kemi një shoqërim të mirëfilltë dhe nuk është mbajtur procesverbal, pasi P.Gj nuk ka qenë i ndaluar/shoqëruar në dhomat e ndalim/shoqërimit si dhe nuk i është mbajtur asnjë nga sendet personale.

Referuar këtij deklarami, Komisioneri vlerëson se legjislacioni i sipërcituar ka të parashikuar vetëm një procedurë shoqërimi të personave dhe në këtë mënyrë punonjësi i policisë është i detyruar për të dokumentuar saktë dhe në mënyrë të plotë veprimet e ndërmarra me të shoqëruarin, për më tepër që P.Gj është marrë dhe në intervistë⁷ nga punonjësit e policisë. Rëndësia që i ka dhënë Policia e Shtetit dokumentimit të veprimeve të punonjësit të policisë, nëpërmjet plotësimit të procesverbalit (Urdhri nr. 938, datë 24.07.2019), pasqyron dhe rëndësinë e këtij momenti, pasi mosplotësimi i procesverbalit nga punonjësi i policisë konsiderohet si shkelje

⁶ <https://shqiptarja.com/lajm/banoret-e-dy-fshatrave-ne-mirdite-proteste-per-ndertimin-e-hecit-dhe-nje-fabrike-uji-ne-zone-perplasen-me-policine-bllokojne-per-disa-minuta-rrugen-e-kombit>
<https://www.balkanweb.com/banoret-e-mirdites-proteste-kunder-ndertimit-te-nje-hec-i-ne-thirre-ne-mbeshtetje-dhe-deputete-te-vv-ne-kosove/>
<https://abcnews.al/protestuon-kunder-hec-it-arrestohet-organizatori-dhe-dy-te-tjere-30-persona-nen-hetim/>

⁷ Referuar informacionit të dërguar nga DVP Lezhë me e-mail-in datë 11.07.2023.

e rëndë dhe ndëshkohet sipas parashikimeve të Rregullores së Policisë. Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se DVP Lezhë nuk ka dhënë një justifikim të arsyeshëm se çfarë lloj shoqërimi ka qenë (duke qenë se nuk është një shoqërim i mirëfilltë) dhe ku është bazuar për këtë lloj shoqërimi.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar dhe shkresës nr. 1690/1, datë 26.04.2023 të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, “..... pra gazetari është ndaluar pas përfundimit të protestës dhe nuk është penguar në kryerje e sipër të misionit të tij, gjithashtu atij nuk i është marrë asnjë nga mjetet e tij të punës, kamera, telefon apo çdo pajisje tjetër që mund të ketë patur me vete.”, Komisioneri ngre dyshimin e arsyeshëm se punonjësit e DVP Lezhë, kanë pasur dijeni se P.Gj ishte gazetar dhe ka se pasur dhe mjetet e gazetarit me vete. Gjithashtu, fakt është që punonjësit e Komisarariatit të Policisë Lezhë, nuk kanë zbatuar parashikimet ligjore për dokumentimin e rastit, duke mos mbajtur Procesverbalin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar (Lidhja 3) dhe duke mos i dhënë një kopje atij.

Pretendimi i DVP Lezhë se P.Gj nuk ka pasur mjetin e identifikimit dhe simbolet e gazetarit, rezulton i pabesueshëm, pasi punonjësit e Komisarariatit të Policisë Lezhë, nuk kanë zbatuar parashikimet ligjore për dokumentimin e rastit, duke mos mbajtur Procesverbalin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar (Lidhja 3) dhe duke mos i dhënë një kopje atij. Mosdisponimi i të dhënave konkrete, e fakteve dhe e rrethaneve objektive nga punonjësit e policisë Lezhë, provon se shoqërimi i gazetarit në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë nuk është bërë në përputhje me kriteret ligjore të parashikuara në ligjin dhe në procedurën standarde të punës të cituar më lart.

Në rastin konkret, meqënëse dokumentimi mund të hidhte dritë nëse gazetari ka pasur apo jo mjete identifikimi formale apo materiale dhe ky dokumentim nuk është bërë nga organet kompetente, merret e mirëqenë që personi ka qenë i dallueshëm si gazetar në momentin e shoqërimit.

Gjithashtu, merret i mirëqenë dhe deklarimi i ankuesit që i ka vënë në dijeni punonjësit e policisë se është gazetar dhe në këtë kuptim dhe inspektori i policisë që ka bërë dorëzimin e tij në Komisarariatin e Policisë Lezhë dhe punonjësi i policisë Lezhë, kur janë njohur me deklarin se P.Gj ishte gazetar dhe kishte qenë në vendngjarje për të raportuar ngjarjen, nuk duhet të kishin kryer shoqërimin e tij.

Në çështjen Najafli kundër Azerbajxhanit çështja nr. 2594/07, 2 Tetor 2012, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në paragrafin 67-68, ka cituar ndër të tjera se: “...Megjithëse gazetari nuk kishte veshje të dallueshme, ai kishte të varur mjetin e identifikimit të gazetarit dhe kishte deklaruar specifikisht oficerëve të policisë se ishte gazetar”. Gjykata jo vetëm që gjeti shkelje të Nenit 3 për shkak të keqtrajtimit, por edhe shkelje të Nenit 10 të Konventës (Liria e shprehjes). Gjykata deklaroi se përdorimi i forcës së tepruar ndaj gazetarëve ndërsa ata ishin duke kryer detyrat e tyre profesionale, pengon seriozisht ushtrimin e tyre të së drejtës për të marrë dhe për të dhënë informacion, pavarësisht nëse kishte ndonjë qëllim nga ana e policisë për të ndërhyrë në aktivitetin e tyre.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se për ngjarjen e ndodhur në datë 11.04.2021, në fshatin Fan-Mirditë, Policia e Shtetit ka kryer veprime procedurale duke arrestuar në flagrancë 4 shtetas dhe ka referuar materiale në ngarkim të 30 personave të tjerë.

Referuar intervistës së dhënë nga P.Gj në televizionin Fax News⁸, pas daljes nga mjediset e Komisarariatit por dhe fotografisë së dërguar për qëndrimin në mjediset e brendshme të Komisarariatit të Policisë Lezhë, rezulton se P.Gj ka deklaruar se ka qenë duke raportuar ngjarjen ka paraqitur dokumentet e tij, por punonjësit e policisë nuk i kanë marrë parasysh. Gjithashtu gjatë intervistës P.Gj ka deklaruar se i kanë sekuestruar telefonat, dokumentin e identifikimit dhe të gazetarit, gjë e cila nuk është pasqyruar në Procesverbalin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar (Lidhja 3).

Fakti që DVP Lezhë deklaron se P.Gj ka qëndruar në mjediset e jashtme të Komisarariatit (mjedisi për pritjen e qytetarëve) dhe se është shoqëruar për verifikim, ngre dyshimin se punonjësit e policisë kanë pasur dijeni/dyshime se P.Gj ishte gazetar, për më tepër që i janë mbajtur dhe sendet personale (këto të padeklaruara me procesverbal) si celulari i P.Gj, në të cilin mund të vërtetohej se ai ka qenë duke komunikuar me redaksinë e televizionit Fax News, për të raportuar protestën.

Pavarësisht faktit që Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit, parashikojnë të drejtën e punonjësit të policisë të aplikojë shoqërimin e një personi për identifikim apo sqarimin e rrethanave, Komisioneri vlerëson se DVP Lezhë nuk arriti të provojë se P.Gj nuk ka pasur shenjat e identifikimit si gazetar dhe nuk i ka deklaruar punonjësit të policisë që është gazetar, fakt që do ishte provuar lehtësisht, nëse do ishte mbajtur procesverbali sipas parashikimeve ligjore.

Referuar kronikave televizive të televizionit Fax News⁹, rezulton se P.Gj është një gazetar lokal i njohur në Lezhë. Gjithashtu, referuar dhe informacionit¹⁰ të DVP Lezhë, rezulton se P.Gj ka qenë i njohur nga punonjësit e policisë dhe për më tepër është etiketuar si person problematik dhe konfliktual që në disa raste ka cenuar figurën e punonjësve të policisë në Lezhë.

Në përfundim Komisioneri vlerëson se për vetë profilin mediatik të P.Gj në qytetin e Lezhës dhe mjeteve të punës që ka pasur në dispozicion në momentin e shoqërimit si dhe deklarimit të tij si gazetar, punonjësit e policisë kanë pasur mundësi reale që ta identifikonin, P.Gj si gazetar.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se gazetari P.Gj nuk duhej të ishte shoqëruar nga punonjësit e policisë, pasi ai nuk ishte në kushte të njëjta me qytetarët e tjerë që po udhëtonin me mikrobus. Njëkohësisht ai nuk mund të krahasohet me gazetarët e të tjerë në vendngjarje pasi është ndaluar rreth 40 km nga vendngjarja dhe nuk mund të konsiderehohet në kushte të njëjta me ta.

⁸ <https://www.youtube.com/watch?app=desktop&v=>

⁹ <https://www.faxweb.al/shengjin-https://www.faxweb.al/shkoder-koplikhttps://www.faxweb.al/video-rama-iu-thote-mos-dilni-bashkia-i-mbledh>

¹⁰ Referuar informacionit dhe deklarimit gjatë seancës dëgjimore.

Në përfundim të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, e gjithë procedura e ndjekur nga ana e punonjësve të policisë, lidhur me shoqërimin dhe mos dokumentimin e rastit, duke mos mbajtur Procesverbalin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar (Lidhja 3), si dhe duke e njohur atë si gazetar lokal e për më tepër duke e identifikuar si person problematik dhe konfliktual me punonjësit e policisë¹¹, e ka ekspozuar haptazi P.Gj para një trajtimi të padrejtë e të pabarabartë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Ankuesi pretendon se është diskriminuar nga DVP Lezhë për shkak të bindjeve politike, linjës kritike të televizionit Fax News dhe për çdo shkak tjetër (të profesionit si gazetar kritik).

Mbështetur në nenin 2¹², të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

B.1 “Bindjet politike”.

Lidhur me këtë shkak ankuesi nuk ka sjellë asnjë informacion apo dokumentacion për të provuar/arsyetuar bindjet politike. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pretendimi i ankuesit se është diskriminuar për shkak të bindjes politike është i pabazuar.

B.2 “Çdo shkak tjetër”.

Gjatë parashtrimeve subjekti ankues ka pretenduar diskriminim për “çdo shkak tjetër”, duke argumentuar se trajtimi i padrejtë e i pafavorshëm ndaj tij ka qënë për shkak:

¹¹ Referuar informacionit dhe deklaratimit gjatë seancës dëgjimore.

¹² “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

1. Të profesionit të tij si gazetar lokal që raporton për problematikat e zonës.
2. Televizioni (Fax News) ku punonte kishte një linjë editoriale të tillë ku fokusi i kësaj medie ka qenë evidentimi i problematikave të ndryshme në nivel lokal.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh¹³. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh¹⁴.

Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bëjnë të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar staturat të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “me çdo shkak tjetër”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

GJEDNJ-ja ka zhvilluar disa shkaqe në kategorinë “staturat të tjera”. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, personale, ose “status”, me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri¹⁵. Gjykata ka theksuar se fjalës “shkak/status tjetër” në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë¹⁶. Interpretimi i këtij nocioni

¹³ Neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

¹⁴ Neni 14, i KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

¹⁵ Shih: Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 55; Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës, prg 56; Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 61 dhe 70; Novruk dhe të tjerët kundër Rusisë, prg. 90.

¹⁶ Shiko: Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, prg 70.

“nuk është kufizuar në karakteristika që janë personale në kuptimin që ato janë të lindura apo të pandashme”¹⁷.

Disa karakteristika që GJEDNJ-ja ka njohur se mbrohen në kuadër të “statuseve të tjera” janë: Në Engel dhe të tjerët kundër Vendeve të Ulta, Gjykata vendosi që një dallim i bazuar në gradën ushtarake mund të binte në kundërshtim me nenin 14; në Larkos kundër Qipros, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i një dallimi midis qiramarrësve të shtetit nga njëra anë dhe qiramarrësve të pronarëve privatë nga ana tjetër; në Shelley kundër Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata konsideroi se të qenit i burgosur mund të binte në nocionin e "statusit tjetër" sipas nenit 14; në Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë, Gjykata nuk adresoi në mënyrë specifike çështjen e “statusit tjetër”, por në gjetjen e një shkelje të nenit 14 dhe nenit 8 pranoi se statusi si ish oficer i KGB-së përfshihet në nenin 14; në Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i dallimit që bëhej nga skema e lirimimit të parakohshëm bazuar në kohëzgjatjen e dënimit me burg.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.*

Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit se shkak për trajtimin e tij të padrejtë e të pafavorshëm është bërë për arsye të profesionit të tij si gazetar lokal i njohur nga punonjësit e policisë së shtetit dhe se televizioni (Fax News) ku punonte kishte një linjë editoriale të tillë ku fokusi i kësaj medie dhe gazetarit ka qenë evidentimi i problematikave të ndryshme në nivel lokal, qëndron dhe është i provuar, bazuar në provat e depozituara në dosje¹⁸.

Gjithashtu, referuar dhe informacionit¹⁹ të DVP Lezhë, rezulton se P.Gj njihej dhe etiketohej si person problematik dhe konfliktual dhe që në disa raste ka cenuar figurën e punonjësve të policisë në Lezhë.

Në këtë kontekst, bazuar në deklaratimet, faktet e provat e sjella nga palët, Komisioneri vlerëson si shkaqe të mbrojtura nga LMD, referuar si *“çdo shkak tjetër”²⁰*.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur.

Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar faktin, nëse subjekti ankues, është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga ana e DVP Lezhë dhe konkludoi se e gjithë procedura e ndjekur

¹⁷ Shiko: *Biao kundër Danimarkës*, aplikimi nr. 38590/10, prg.89.

¹⁸ <https://www.faxweb.al/shengjin>
<https://www.faxweb.al/shkoder-koplik>
<https://www.faxweb.al/video-rama-iu-thote-mos-dilni-bashkia>

¹⁹ Referuar informacionit dhe deklaratimit gjatë seancës dëgjimore.

²⁰ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 151, datë 28.10.2020, Vendimin nr. 151, datë 11.08.2021 dhe Vendimin nr. 170, datë 28.08.2023 të KMD-së.

nga ana e punonjësve të policisë, lidhur me mos dokumentimin e rastit, duke mos mbajtur Procesverbalin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar (Lidhja 3) dhe duke e identifikuar si person problematik, e ka ekspozuar haptazi P.Gj para një trajtimi të padrejtë e të pabarabartë krahasuar me përcaktimet ligjore dhe me gazetarët e tjerë pjesëmarrës në protestë.

Komisioneri e ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e DVP Lezhë se nuk është ndaluar asnjë gazetar tjetër duke u kthyer nga vendi i protestës, pasi P.Gj nuk ka qenë në të njëjtat kushte me gazetarët e tjerë në vendngjarje për të cilët nuk ka informacion se si kanë udhëtuar, me mjete transporti publik apo me mjete private, të dallueshmë apo jo, pasi ai është ndaluar rreth 40 km nga vendngjarja. Nga ana e DVP Lezhë nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin se P.Gj nuk ka pasur shenjat e identifikimit si gazetar dhe se DVP Lezhë ka ndjekur procedurën ligjore lidhur me dokumentimin e rastit. Gjithashtu, rezultoi e provuar se P.Gj është një gazetar lokal që raportonte për televizionin Fax News dhe se njihej nga punonjësit e policisë i identifikuar edhe si person problematik dhe konfliktual.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive për trajtimin ndryshe të evidentuar. Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këto shkaqe, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt. Kjo në këndvështrimin referuar faktit nëse, DVP Lezhë, ka respektuar procedurën ligjore për shoqërimin e gazetarit në Komisariatin e Policisë Lezhë.

Lidhur me sa më lart, Komisioneri ka vlerësuar se ankuesi është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë e në shkelje të dispozitave sa më sipër cituar, në të drejtën e tij, për të ushtruar profesionin e gazetarit dhe të medias Fax News për të raportuar ngjarjen.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 23 të Kushtetutës, sipas të cilit “1. E drejta e informimit është e garantuar” dhe nenit 27 “1. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara në ligj”.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material.

Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor²¹.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njih dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokollin 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa Neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.²²

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), në nenin 5, pika 1 të saj parashikon të drejtën për liri dhe siguri, në të cilën përcaktohet se: “Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj; a.”.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), në nenin 10, pika 1 të saj parashikon të drejtën për lirinë e shprehjes, në të cilën përcaktohet se: “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit audio, kinematografik ose televiziv”.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “*diskriminimi*” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme.

²¹Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011; nr. 23, datë 08.06.2011.

²²https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discrim_law_SQL.pdf, faqet 47 dhe 49

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Në bazë të ligjit, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit përcaktohet se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.

Në nenin 3, pika 3, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se: “3. “Diskriminim ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit”.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është dhe diskriminimi i tërthortë, i cili përkufizohet nga neni 3, pika 7, e ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

Sa më sipër rezulton se gëzimi dhe ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët i të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe çdo të drejte tjetër që buron nga ligjet në fuqi, garantohet duke eliminuar diskriminimin formal dhe atë substancial. Diskriminimi mund të rezultojë jo vetëm nga trajtimi i ndryshëm i njerëzve në situata të njëjta (diskriminimi formal), por gjithashtu duke ofruar të njëjtin trajtim për njerëzit në situata të ndryshme (diskriminimi substancial). Ky i fundit quhet diskriminim “i tërthortë”, sepse nuk është trajtimi që ndryshon, por janë më tepër pasojat e atij trajtimi, që do të ndjehen ndryshe nga njerëzit me karakteristika të ndryshme. Diskriminimi i tërthortë ndodh kur një mundësi e cila në dukje është e aksesueshme në realitet përjashton persona të caktuar për shkak se statusi i tyre nuk i lejon ata që të përfitojnë nga kjo mundësi. Referuar përkufizimit ligjor elementët diskriminimit e tërthortë janë si më poshtë:

- një dispozitë, kriter apo praktikë në dukje neutrale;
- që prek një grup të përcaktuar nga një “shkak i mbrojtur” në një mënyrë shumë më negative;
- duke krahasuar të tjerët në një situatë të ngjashme.

Kriteri i parë i identifikueshëm është një dispozitë, kriter ose praktike neutrale. Në pamje të parë praktika (ndalimi/shoqërimi) që kanë ndjekur punonjësit e policisë së DVP Lezhë pas zhvillimit të

protestes së paligjshme ka qenë e njëjtë për të gjithë personat e mikrobusit në të cilin po udhëtonte dhe P.Gj. Pra nuk ka trajtim të diferencuar midis personave që po udhëtonin.

Kriteri i dytë i identifikueshëm është se dispozita, kriteri ose praktika neutrale e vendos një “grup të mbrojtur” në një disavantazh të caktuar. Për këtë arsye diskriminimi i tërthortë ndryshon nga diskriminimi i drejtpërdrejtë sepse e zhvendos fokusin larg nga trajtimi i ndryshëm për të parë efektet e ndryshme. Në çështjen objekt shqyrtimi, P.Gj në pamje të parë nuk ka patur pengesë që të ndjekë dhe raportojë zhvillimin e protestës në datë 11.04.2021, por në fakt për shkak të shoqërimit ai nuk ka pasur mundësi për të kryer detyrën e tij, për të informuar/raportuar ngjarjen pas zhvillimit të protestës dhe ndalimit/shoqërimit të protestuesve për në mjediset e DVP Lezhë. Pra, praktika e ndjekur nga punonjësit e policisë e ka vendosur gazetarin P.Gj në kushte më pak të favorshme në raport me personat e tjerë.

Veprimet negative kundër gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut, sepse ato synojnë jo vetëm individët, por privojnë të tjerët nga e drejta e tyre për të marrë informacion, duke kufizuar debatin publik, i cili përbën thelbin e demokracisë pluraliste.

Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, në 13 prill 2016 miratoi Rekomandimin CM/Rec (2016)4 për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias. Në pikën 11 të Shtojcës së Rekomandimit CM/Rec (2016)4 është përcaktuar se: *“Në të gjitha rastet e heqjes së lirisë së gazetarëve ose aktorëve të tjerë të medias nga ana e policisë ose zyrtarëve të tjerë të zbatimit të ligjit, duhet të respektohen garancitë e duhura procedurale, me qëllim parandalimin e ndalimit ose keqtrajtimit të paligjshëm. Garancitë e tilla procedurale duhet të përfshijnë: të drejtën për të informuar ose për t’u informuar një palë e tretë e zgjedhjes së tyre për heqjen e lirisë së tyre, vendndodhjen e tyre dhe çdo transferim; të drejtën për të marrë një avokat; të drejtën për të pasur një mjek; dhe të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit para një gjykate. Personat e arrestuar ose të paraburgosur duhet të sillen menjëherë përpara një gjyqtari në lidhje me kryerjen e një vepre penale, dhe ata kanë të drejtën e gjyqimit brenda një kohe të arsyeshme ose të lëshohen në pritje të gjyqimit, në përputhje me Nenin 5 të Konventës (e drejta për liri dhe siguri)”,* ndërsa në pikën 39 përcaktohet se: *“Sulmet dhe frikësimet e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias në mënyrë të pashmangshme kanë një efekt të rëndë, të frikshëm ndaj lirisë së shprehjes, dhe ky efekt është më i mprehtë kur përhapja e sulmeve dhe kërcënimeve është e përbërë nga një kulturë e mosndëshkimit ligjor për autorët e tyre. Një kulturë e tillë e mosndëshkimit ligjor është një tregues i abuzimit tipik të të drejtave të njeriut”.*

Situata e respektimit të të drejtave të gazetarëve është përshkruar dhe nga Komisioni Evropian, në Raport Progresin për Shqipërinë të vitit 2022, pika 1.2 Liria e Shprehjes, faqe 5, në të cilën ka konstatuar se: *“...Atmosfera e sulmeve verbale, fushatave shpifëse dhe akteve të frikësimit ndaj gazetarëve nuk është përmirësuar.....”.*

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

GJEDNJ-ja pranon si fakte ato vlerësime “...të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara²³”.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

I njëjti rregullim në lidhje me barrën e provës parashikohet edhe në nenin 82, pika 2 e Kodit të Procedurës Administrative, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie*

²³ GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Ruisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut/shkaqeve të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të padrejtë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun/shkaqet e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse DVP Lezhë, që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin²⁴.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij:

“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni dhe i janë ofruar mundësitë që të japë shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Bazuar në konkluzionet e pjesës A, të Vendimit, Komisioneri konkludoi se e gjithë procedura e ndjekur nga ana e punonjësve të policisë, lidhur me shoqërimin, mos dokumentimin e rastit, duke mos mbajtur Procesverbalin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar (Lidhja 3) dhe duke e njohur si gazetar e duke e identifikuar si person problematik, e ka ekspozuar haptazi P.Gj para një trajtimi të padrejtë e të pabarabartë.

Njëkohësisht sa më sipër, rezultuan të provuara shkaqet e pretenduara nga ankuesi, atë të profesionit të gazetarit lokal që raporton për problematikën e zonës²⁵ dhe se Televizioni (Fax News) ku punonte kishte një linjë editoriale të tillë ku fokusi i kësaj medie ka qenë evidentimi i problematikave të ndryshme në nivel lokal. Gjithashtu, rezulton e provuar se punonjësit e policisë e kanë njohur P.Gj si problematik dhe konfliktual me punonjësit e policisë dhe se ishte i vetmi gazetar që është ndaluar ditën e zhvillimit të protestës.

²⁴ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

²⁵ <https://www.faxweb.al/shengjin>
<https://www.faxweb.al/shkoder-koplik>
<https://www.faxweb.al/video-rama-iu-thote-mos-dilni-bashkia>

Në analizë përsa më sipër, Komisioneri krijon bindjen se ankuesi është diskriminuar, duke u mbështetur në faktin që:

- DVP Lezhë nuk ka ndjekur procedurën ligjore lidhur me dokumentimin e rastit, duke mos mbajtur Procesverbalin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar (Lidhja 3)
- DVP Lezhë e ka njohur ankuesin si dhe e ka etiketuar si person problematik që në disa raste ka cenuar figurën e policisë Lezhë dhe konfliktual me punonjësit e policisë.
- DVP Lezhë nuk arriti të provojë se P.Gj nuk ka pasur shenjat e identifikimit dhe mjetet e punës së gazetarit, për të cilën kishte edhe detyrim ligjor.

Në këtë kontekst, DPV Lezhë, në parashtrimet e tyre nuk arritën të provonin se procedura e ndjekur prej tyre, është konform akteve rregullatore përkatëse, por janë investuar të argumentojnë se P.Gj nuk ka pasur shenjat e identifikimit si gazetar dhe vendimmarrja e tyre ishte e drejtë dhe ligjshme. Për këtë fakt Komisioneri ka bërë analizën ligjore, në të cilën ka konkluduar se nuk është respektuar procedura ligjore për dokumentimin e shoqërimit të ankuesit dhe në këtë rast DVP Lezhë e ka të pamundur të provojë se P.Gj nuk ka dokumentuar apo deklaruar se është gazetar dhe se ka qenë në vendin e ngjarjes duke raportuar protestën.

Kodi i Procedurës Administrative dhe ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, kanë saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palëstjetër/organit publik, në këtë rast DVP Lezhë, e cila duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, për shkakun e pretenduar prej tij.

Sjellja dhe trajtimi diskriminues, gjithashtu, është çdo sjellje aktive ose pasive ndaj çdo personi nga ana e pushtetit, si dhe nga ana e personave fizikë dhe juridikë të sektorit privat dhe publik në jetën publike, që krijon baza për privilegjimin ose mosprivilegjimin e ndonjë personi në mënyrë të paarsyeshme, ose kur e ekspozon në sjellje të padrejtë degraduese në krahasim me persona të tjerë në situatë të ngjashme, që mbështetet mbi çdo bazë diskriminuese.

Mosdiskriminimi është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t’u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet. Kjo e drejtë është sanksionuar dhe mbrohet edhe me ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Komisioneri vlerëson se, pretendimi për diskriminim ndaj DVP Lezhë, duhet të vlerësohet në kuadër të parashikimeve të nenit 3, pika 3, të LMD, pasi konstatohet se ankuesi është diskriminuar si pasojë e ndërveprimit të më shumë se një shkakun dhe konkretisht, atë të profesionit të gazetarit lokal që raporton për problematikat e zonës²⁶, Televizioni (Fax News) ku punonte kishte një linjë editoriale të tillë ku fokusi i kësaj medie ka qenë evidentimi i problematikave të ndryshme në nivel lokal, si dhe faktit që është njohur si gazetar problematik në zonë, shkaqe të cilat kanë bashkëvepruar në një mënyrë të pandashme me njëri tjetrin në të njëjtën kohë për të prodhuar situatën diskriminuese, atë të trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të

²⁶ <https://www.faxweb.al/shengjin-motorri-i-ujit/>
<https://www.faxweb.al/shkoder-koplik-makina-e-policise/>
<https://www.faxweb.al/video-rama-iu-thote-mos-dilni-bashkia-i-mbledh-duce-shperndare-ndihma-pamje-skandaloze-nga-lezha/>

pabarabartë të cilit i është nënshtruar z. P.Gj si rezultat i shoqërimit të vetëm këtij gazetari lokal dhe të mosrespektimit të procedurës ligjore të shoqërimit të tij.

Nga ana tjetër, situata e ankuesit, nuk është e njëjtë me gazetarët e tjerë të cilët nuk janë ndaluar gjatë raportimit të protestës. Rezultoi se, gjatë raportimit të protestës asnjë gazetar nuk është shoqëruar apo ndaluar nga policia. Ankuesi është ndaluar dhe shoqëruar rreth 40 km larg nga vendi i protestës duke udhëtuar në një mjet transporti publik. Në këto kushte, situata e ankuesit nuk është e njëjtë me gazetarët e tjerë gjatë raportimit të protestës.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se praktika e ndjekur nga DVP Lezhë për shoqërimin e ankuesit me justifikimin si pjesëmarrës në një protestë të paligjshme, në dukje e barabartë me personat e tjerë në mjetin publik, vjen në kundërshtim me ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, pasi e vendos ankuesin në pozita diskriminuese për shkak të profesionit të gazetarit lokal që raporton për problematikat e zonës dhe se televizioni ku punonte kishte një linjë editoriale të tillë ku fokusi i kësaj medie ka qenë evidentimi i problematikave të ndryshme në nivel lokal.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara Komisioneri nuk gjen asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, në lidhje me trajtimin të cilit i është nënshtruar ankuesi. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se DVP Lezhë, nuk ka trajtuar në mënyrë të diferencuar gazetarin P.Gj për të informuar/raportuar ngjarjet pas zhvillimit të protestës, duke e vendosuar atë në një situatë diskriminuese.

Sa më sipër, rezultojnë e provuar lidhja shkakësore midis shkaqeve të mbrojtura dhe trajtimit të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i është nënshtruar ankuesi, për arsye të mosrespektimit të legjislacionit të sipërcituar për dokumentimin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar.

Lidhur me situatën e krijuar nga DVP Lezhë, për shoqërimin e gazetarit P.Gj, Komisioneri vlerëson të rëndësishme të evidentojë dhe qëndrimin e Unionit të Gazetarëve Shqiptarë²⁷, Unionit të Gazetarëve Profesionistë të Veriut dhe Unionit të Gazetarëve Lezhë, të cilët në datë 11.04.2021, kanë publikuar një deklaratë në mbrojtje të reporterit të televizionit Fax News, P.Gj, duke dënuar veprimet e strukturave të DVP Lezhë të cilat kanë penguar punën e gazetarëve në shërbim të informimit të publikut.

Bazuar në rrethanat e konstatuara si më sipër dhe nisur nga rëndësia e kësaj çështje, Komisioneri vlerëson të evidentojë disa çështje në lidhje me qasjen e treguar nga ana e DVP Lezhë.

Punonjësit e Komisarariatit të Policisë së Shtetit duhet të jenë të vëmendshëm ndaj shenjave dhe kredencialeve të gazetarëve. Për më tepër, mungesa e këtyre kredencialeve nuk duhet të përdoret si pretekst për kufizime të padrejta në aktivitetin e gazetarit. Kur gazetarët nuk janë në gjendje të

²⁷ <https://newsalbania.al/policia-e-lezhes-ndalon-gazetarin-reagon-unioni-i-gazetareve-shqiptare/>
<https://www.shkodraweb.com/policia-e-shtetit-shoqeron-gazetarin-e-faxnews-ne-lezhe-ndersa-nuk-jep-ende-arsyen-zyrtare/>
<https://www.zeriamerikes.com/a>

dokumentojnë statusin e tyre, autoritetet duhet të përpiqen ta verifikojnë atë me mjete të tjera, duke konsultuar organizatat profesionale të gazetarëve që mund të konfirmojnë në kohë reale statusin e gazetarit.

Bazuar në veprimet procedurale të punonjësve të policisë, rezulton se nuk kanë zbatuar parashikimet ligjore për dokumentimin e rastit. Kjo shkelje e ligjit nuk cenon vetëm të drejtat ligjore të shtetasve të caktuar, por në të njëjtën kohë dëmton imazhin dhe besimin e Policisë së Shtetit në publik.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka diskriminuar ankuesin në të drejtën e tij për të ushtruar profesionin e gazetarit për të raportuar ngjarjet e zhvilluara pas protestës, në formën e diskriminimit ndërsektorial dhe të tërthortë, trajtim i cili ka ardhur si pasojë e identifikimit të P.Gj si gazetar lokal që raporton për problematikat e zonës dhe se televizioni Fax News kishte një linjë editoriale për evidentimin e e problemeve në nivel lokal.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit, në formën e diskriminimit ndërsektorial dhe të tërthortë, të ankuesit, z. P.Gj, për shkaqet e pretenduara prej tij, nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA